



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A.nr. 198/2011**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga Ymer Hoxha kryesues, Hasan Rexha dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Ermina Jonuzi, kandidate për këshilltare komunale nga subjekti politik Nova Demokrtska Stranka (NDS) me seli në Prizren, paraqitur kundër Emilja Rexhepi, gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 23.03.2011, mori këtë:

## V E N D I M

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e Ermina Jonuzi, kandidate për këshilltare komunale nga subjekti politik Nova Demokrtska Stranka (NDS) me seli në Prizren dhe konstatohet se e njëjta është kandidate sipas radhës në listë si këshilltare për asamblenë komunale.

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 21.03.2011, nga Ermina Jonuzi, kandidate për këshilltare komunale nga subjekti politik NDS me te cilën pretendohet se më datë 14.03.2011 ka pranuar një ftesë për dhënien e betimit solemn në mbledhjen e kuvendit komunal të Prizrenit e caktuar më datë 17.03.2011, me rastin e fillimit të mbledhjes së kuvendit, Emilja Rexhepi ish këshilltare komunale në Kuvendin Komunal Prizren ka hyrë dhe ka penguar dhënien e betimit.

Sipas parashtrueses së ankesës në bazë të nenit 46 pika a) e statutit të komunës këshilltarët e humbin mandatin nëse nuk e nënshkruajnë betimin në afatin prej 1 muaji (30 ditësh) nga dita e emërimit, respektivisht nga data 01.03.2011.

Parashtruesja e ankesës ka bashkangjitur si provë Vendimin e KQZ-së me nr. 316 të datës 01.03.2011.

Parashtruesja e ankesës kërkon nga personat e autorizuar të PZAP-it dhe të KQZ-së që ti mundësojnë, në një afat sa më të shkurtër kohor që të bëjë betimin solemn brenda afatit ligjor.

Neni 10 paragrafi 3 i LZL-së, specifikon

**Zëvendësimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës**

*10.3 KQZ-ja plotëson vendin e lirë sipas kritereve të përcaktuara në vijim:*

*a) nga kandidati i radhës i kualifikuar të njëjtës gjini që gjendet në listën e rirënditur të kandidatëve të njëjtit subjekt politik*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Emilja Rexhepi ish këshilltare në KK në Prizren, nga radhët e subjektit politik NDS, ka dhënë dorëheqje në mandatin e saj për shkak zgjedhjes së saj për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës në zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010. Në pajtim me dispozitat e nenit 10.3 (a) të Ligjit nr.03/L-72 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, zëvendësohet me kandidatin e radhës nga lista e subjektit të njëjtë politik dhe me gjini të njëjtë Ermina Jonuzi.

Andaj për këtë arsye PZAP konstaton se Emilja Rexhepi zëvendësohet me Ermina Jonuzin, si këshilltare e KK Prizren nga radhët e subjektit politik NDS. Prandaj për këto arsye si dhe në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrasa**

A nr. 198/2011 më datën 23.03.2011

**Kryesuesi i Panelit  
Ymer Hoxha**

